

**PËRSHKRIM I PROÇEDURAVE TË ZGJEDHJES, KOMPETENCAVE TË  
FUNKSIONARËVE TË LARTË TË BASHKISË MALLAKASTËR DHE PROÇEDURA  
E NDJEKJES PËR MARRJEN E VENDIMEVE.**

**ORGANET E NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE**

1. Në çdo bashki dhe qark krijohet organi përfaqësues dhe organi ekzekutiv.
2. Organi përfaqësues i bashkisë është këshilli bashkiak.
- 3. Organi ekzekutiv i bashkisë është kryetari i bashkisë**
4. Organet përfaqësuese dhe ekzekutive të bashkisë zgjidhen në përputhje me Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

**KRYETARI I BASHKISË**

1. Bashkia Mallakastër ka kryetar z. **Agron Fasli Kapllanaj**, të zgjedhur sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor.
2. Kryetari i bashkisë mund të zgjidhet dhe të ushtrojë vetëm 3 mandate të njëpasnjëshme në krye të bashkisë, me të drejtë rizgjedhjeje.

**Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë**

Kryetari i bashkisë ka këto kompetenca dhe detyra:

- a) Kryetari i Bashkisë organizon dhe drejton punën e Administratës për kryerjen e funksioneve të Bashkisë, nëpërmjet urdhërave, urdhëresave dhe vendimeve.
- b) Ushtron të gjitha kompetencat në kryerjen e funksioneve të bashkisë, me përjashtim të atyre që janë kompetencë vetëm e këshillit përkatës;
- c) Zbaton aktet e këshillit;
- ç) Merr masa për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve për këshillin bashkiak, në përputhje me rendin e ditës së përcaktuar nga këshilli, si dhe për probleme që kërkon ai vetë;
- d) Raporton në këshill për gjendjen ekonomiko-financiare të bashkisë dhe njësive administrative përbërëse të paktën çdo 6 muaj ose sa herë kërkohet nga këshilli;

- dh) Raporton para këshillit sa herë kërkohet prej tij për probleme të tjera që kanë të bëjnë me funksionet e bashkisë;
- e) Është anëtar i këshillit të qarkut;
- ë) Emëron, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, zëvendëskryetarin/zëvendëskryetarët e bashkisë dhe i shkarkon ata;
- f) Emëron, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, administratorët e njësive administrative/lagjeve dhe i shkarkon ata;
- g) Vendos për emërimin ose shkarkimin e anëtarëve të organeve drejtuese të shoqërive tregtare në pronësi të bashkisë, si dhe drejtuesit e ndërmarrjeve e të institucioneve në varësi;
- gj) Emëron dhe shkarkon punonjësit e tjerë të strukturave dhe njësive në varësi të bashkisë, përveç kur parashikohet ndryshe në ligjin për nëpunësin civil;
- h) Ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar bashkisë si person juridik dhe është përfaqësuesi i saj në marrëdhëniet me të tretët;
- i) Merr masa për kualifikimin dhe trajnimin e personelit të administratës, të institucioneve arsimore, sociale, kulturore e sportive;
- j) Kthen për rishqyrtim jo më shumë se një herë në këshill vendime, kur vëren se ato cenojnë interesat e bashkësisë. Në rastin e kthimit të vendimit të këshillit nga kryetari i bashkisë, këshilli mund të miratojë të njëjtin vendim vetëm me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve;
- k) Miraton strukturën, organikën e kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së bashkisë dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- l) Emëron dhe shkarkon nëpunësit vendorë për barazinë gjinore;
- ll) Kujdeset për mbledhjen dhe përpunimin e statistikave vendore, të ndara sipas gjinisë, dhe siguron publikimin e tyre.

### **Procedura e marrjes së vendimeve**

Kryetari I bashkisë e bazon vendimarrjen në ushtrimin kompetencave të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 64 të cilat janë përmendur gjerësisht më sipër të kompetencat e kryetarit, në kodin e procedurave administrative dhe gjithë legjislacionit shqiptar.

Procedura që ndiqet për marrjen e vendimeve është e ndryshme sipas çdo rasti.

Po përmëndim disa:

Psh: Në rastin kur adresohet një kërkesë nga qytetarët procedura që ndiqet është si më poshtë:

Në rastin kur një qytetar adreson një kërkesë pranë bashkisë, ajo fillimisht rregjistrohet në protokollin hyrës të dokumentacioneve dhe më pas adresohet për ndjekje të saj pranë drejtorisë përkatëse në varësi sipas natyrës së kërkesës. Drejtoria shqyrton kërkesën dhe formulon përgjigjen bazuar në legjislacion dhe kjo vendimarrje kalon më pas për miratim të kryetari i bashkisë i cili bën miratimin ose jo të saj. Në cdo rast i kthehet përgjigje qytetarit.

## **Procedura e marrjes së vendimeve në keshillin bashkiak**

Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak

Këshilli bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca:

- a) zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet;
- b) zgjedh, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, kryetarin dhe zëvendëskryetarët e këshillit dhe i shkarkon ata;
- c) emëron dhe shkarkon sekretarin e këshillit bashkiak;
- ç) miraton nivelin e pagave e të shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- d) miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, si dhe të personave të tjerë juridikë që krijon vetë ose me të cilët është bashkëthemelues;
- dh) miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton, gjithashtu, edhe numrin e maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë;
- e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve;
- ë) organizon dhe mbikëqyr kontrollin e brendshëm të bashkisë;
- f) vendos për taksat e tarifat vendore, sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi;
- g) vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve;
- gj) vendos për krijimin e institucioneve të përbashkëta me njësi të tjera të vetëqeverisjes vendore, përfshirë subjektin e kompetencave të përbashkëta ose me persona të tretë;
- h) vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet;
- i) zgjedh përfaqësuesit e këshillit bashkiak në këshillin e qarkut, të cilët, në jo më pak se 50 për qind të tyre, duhet t'i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar;
- j) vendos për dhënien ose deklarimin e mbarimit të mandatit të këshilltarit, kur ekzistojnë kushtet e parashikuara në nenin 49 të këtij ligji;

k) miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik;

l) vendos për simbolet e bashkisë;

ll) vendos për emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e bashkisë;

m) jep tituj nderi dhe stimuj;

n) vendos për rregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe për zbatim të ligjit, me të cilin bëhet ky delegim te bashkia.

Për rastet kur vendimmarja duhet të kalojë përmes keshillit bashkiak sipas kompetencave të sipërpërmendura. Kryetari I bashkisë nëpërmjet administratës së tij formulon projekt-vendimet të ndryshme sipas natyrës që kërkohet të cilat miratohen fillimisht si projekt-vendime te kryetari I bashkisë I cili pasi I miraton I dërgon zyrtarisht keto propozime për miratim në keshillin bashkiak që të marrin formën e vendimit.

Psh. Rasti kur një organizatë që përfaqëson interesat e një kategorie të caktuar qytetarësh si.psh organizata e familjeve të dëshmorëve ka një propozim për emërtimin e një rruge e cila sipas historisë lidhet me rënien e një dëshmori në atë rrugë. Nga kjo organizatë kërkohet emërtimi I kesaj rruge me emrin e këtij dëshmori. Propozimi drejtohet në bashki nga organizata dhe kryetari I bashkisë nëpërmjet administratës formulon projekt-vendimin bazuar në propozimin e organizatës dhe në ligjin 139/2015 dhe e dërgon atë për miratim në këshillin bashkiak. Është këshilli bashkiak I cili vendos për miratimin ose jo të këtij propozimi.

## **SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

### **KLASIFIKIMI I POZICIONEVE NË SHËRBIMIN CIVIL**

#### **Klasifikimi**

1. Pozicionet e shërbimit civil klasifikohen sipas kategorive, klasave dhe natyrës së pozicionit. Klasifikimi bazohet në përshkrimin e punës të çdo pozicioni.

2. Pozicionet e shërbimit civil ndahen në këto kategori:

a) të lartë drejtues;

b) të mesëm drejtues;

c) të ulët drejtues;

ç) ekzekutiv.

3. Secila nga kategoritë, sipas pikës 2 të këtij neni, ndahet në klasa.

4. Nëpunës civilë të kategorisë së lartë drejtuese janë këto pozicione:

**a) sekretar i përgjithshëm;**

b) drejtor departamenti;

c) drejtor drejtorie të përgjithshme;

ç) pozicionet e barasvlershme me tre të parat.

### **Pranimi i nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese në institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore**

1. Pranimi në kategorinë e nëpunësve civilë të lartë drejtues në institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore bëhet me konkurrim të organizuar për një apo disa pozicione të lira dhe është i hapur për nëpunësit civilë të kategorisë së mesme drejtuese. Përjashtimisht, titullari/organi vendimmarrës i institucionit mund të vendosë që procedura e pranimit të jetë e hapur edhe për kandidatët e tjerë, jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në këtë kategori, por në asnjë rast ky numër nuk mund të jetë më shumë se 15 për qind të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kategorisë së lartë drejtuese për atë institucion. Çdo emërim i kategorisë së lartë drejtuese, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në këtë ligj, është absolutisht i pavlefshëm.

2. Konkurrimi organizohet në përputhje me nenin 20 të këtij ligji nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit.

3. Këshilli i Ministrave miraton rregullat e hollësishme për krijimin, përbërjen dhe veprimtarinë e komiteteve të përhershme të pranimit, si dhe rregullat e hollësishme për procedurën e pranimit dhe vlerësimin e kandidatëve.